

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË MITROVICËN E TITOS, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarëve: Jusuf Mejzini - kryetar, Branko Jarediq - antar, gjyqtarëve porot: Zenel Hamza, Millutin Markoviq dhe Radojica Gjokoviq - antarë, me procesmbajtjen Mevlyde Hamza, në çështjen penale të të akuzuarit REGJEP MEHMETIT për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.1. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ, të të akuzuarëve SHEFQET DIBRANI, QERKIN PEÇI dhe MUSTAFË MULOËLLI, secili veç e veç për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.1. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ, sipas aktakuzës së Prokuroris publike të qarkut në Mitrovicën e Titos PP-nr.84/82 të datës 02.02.1983, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, verbal e publik me datën 26.05.1983 në prezencë të përfaqësuesit të aktakuzës zëvendës PPQ në Mitrovicën e Titos Faruk Korenicës, të akuzuarëve, mbrojtësve të tyre avoketëve: Mehmet Dushkut nga Prishtina, Abedin Naxhiut dhe Zaim Istrefit, të dytë nga Mitrovica e Titos, me datën 27. maj 1983 muarr dhe në prezencë të palëve publikisht shpall këtë

## A K T G J Y K I M

## TË AKUZUARIT:

1. REGJEP MEHMETI, i biri i Hajdarit dhe i azemines e gjinisë Haziri, i lindur më 10.04.1954, në fshatin Dumnice e Ulte komuna e Vuçitornës, ku e ka banorshimin ndbanimin, shqiptar, shtetas i RRFJ, i martuar, bashkë

./...

3 fëmijve të mitur, ka të kryer SHNE - dega për agjystator, momentalisht i pa punë, shërbimin ushtarak e ka rregulluar në Zagreb më 1981, gjindet në EU pranë KK Vuçitërrenë, me gjendje të mesme ekonomike, më parë jo i denuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 05 .08. 1982,

2. SHEFQET DIBRANI, i biri i Aliut dhe i Kadës e gjinisë Ferizi, i lindur më 14 .09. 1944, në fshatin Dumnice e Ultë komuna e Vuçitërrenë, ka e ka edhe vendbanimin, shqiptar, shtetas i RSFJ, i pa martuar, ka të kryer SHNE - dega për vegëltar, punëtor në fabrikën "Poliester" në Podujevë, shërbimin ushtarak nuk e ka rregulluar, i pa dekoruar, me gjendje të varfur ekonomike, ka qenë i gjykuar nga ëna e Gjykatës së qaraut në Fryshtinë për veprën penale Vrasje me denim burgimi në kohë zgjatje prej 15 vjetësh e denimin e ka vuajtur përfundimisht gjer në vitin 1979, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 05 .08. 1982,

3. QERKIN PEGI, i biri i Hajdarit dhe i Halime e gjinisë Haziri, i lindur më 20 .04. 1944 në fshatin Zhazhë komuna e Mitrovicës së Titos, vendbanimin e ka në Mitrovicën e Titos në lagjën "Tamnik" rruga 8 nr.30, shqiptar, shtetas i RSFJ, profesor i gjuhës dhe i letërsisë shqipe, ka të kryer Fakultetin filozofik - grupi i albanologjis, i martuar, babë i 3 fëmijve të mitur, shërbimin ushtarak e ka rregulluar në Nish më 1971, gjindet në EU pranë KK Mitrovicë e Titos, i pa dekoruar, me gjendje të mesme ekonomike, më parë jo i denuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej 05 .08. 1982.

4. MUSTAFË MULOULLI, i biri i Krustemit dhe i Mihones e gjinisë Fejzullahu, i lindur më 03 .10. 1955 në fshatin Shajkovcë komuna e Fodujevës ku e ka edhe vëndbanimin, shqiptar, shtetas i RSHJ, ka të kryer dy klasë të shkollës së mesme ekonomike, punëtor administrativ - shapillografist, i martuar, babë i 1 fëmijë të mitur, nga shërbimi ushtarak në vitin 1977 është lëshuar si i pa aftë, i pa dekoruar, me gjendje të varfur ekonomike, më parë jo i denuar, kundër tij nuk zbatohet procedura për ndonjë vepër tjetër penale, gjindet në paraburgim prej datës 05 .08. 1982,

### J a n ë f a j t o r ë

SEFSE:

#### I. REGJEP BEHMETI:

Nga mesi i muajit shkurt të vitit 1982, me qëllim që të rrëxojë pushtetin e klasës punëtoare dhe të punonjësve, të minojë rregullimin shoqëror-ekonomik të përcaktuar në kushtetut, sistemin shoqëror - politik e sistemin e vetëqeverisjes, bazën ekonomike të vendit, thyrjen e vllazërimit e të bashkimit, prishjen e baranisë së kombeve e të kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit, në nitrovicën e Titos ka formuar grupin armiqësor të ashtuquajtur "treshi" të përbërë prej të akuzuarëve Shefqet Dibranit, Merkin Lecit dhe Mustafë Mulollit, i cili grup është pjesë përbërëse e organizatave armiqësore: "Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve tjera të banuara me shqiptar në Jugosllavi" ("LNÇK-VSHJ") dhe "Partisë komuniste Marksiste Leniniste të shqiptarëve në Jugosllavi"

("PKM-LSHJ") dhe prej datës 19 .02. 1982 "Lëvizja për republikën shqiptare në kuadër të Jugosllavis", i cili pastaj, si udhëheqës i grupit me datën 09 .05. 1982 dhe më vonë ka organizua dhe shpërnda 90 egzemplarë të afishes "komunikat" dhe më tepër se 150 egzemplarë të afishes "thirrje" e kjo e fundit me këtë përmbajtje: "në të cilën ftohen punëtorët, fshatarët, qytetarët, nxënësit dhe studentët, njerzë të çdo moshe që me datën 26 .06. 1982 kur fillon Kongresi XII i LKJ të lëshojnë punën, dyqanet, fushat e arat dhe të dalin në rrugë me qëllim të brohoritjes dhe të kërkojnë të drejtat e veta për krijimin e republikës së Kosovës në Jugosllavi", e të cilat krejtë kanë pasur përmbajtje armiqësore, në atë mënyrë që një sasi të të njejtave ka shpërnda duke futur në pliko dhe adresuar personave të ndryshëm ndërsa sasinë tjetër i ka shpërnda duke vendosur nëpër vende të ndryshme, e krejtë në teritorin e KSA të Kosovës,

- me këtë ka kryer veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.1. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontraregulacionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ.

II. SHEFQET DIBRANI, QERKIN BECI dhe MUSTAFI  
MULOGLI:

Nga mesi i muajit shkurt të vitit 1982 në Mitrovicën e Titos, me qëllim që ta rrëzojnë pushtetin e klasës punëtore dhe të punonjësve, të minojnë rregullimin shoqëror - ekonomik të përcaktuar me kushtetutë, sistemin shoqëror - politik e sistemin e vetëqeverisjes, bazën ekonomike të vendit, thyrrjen e vllazërimit e të bashkimit të vendit, prishjen e barazisë së kombeve e të kombësive dhe ndryshimin antikushtetues të rregullimit federativ të shtetit, janë bërë antarë të grupit armiqësor

"treshit", i cili është pjesë përbërse e organizatave armiqësore: "Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve tjera të banuara me shqiptar në Jugosllavi" ("LNQK-VSHJ"), dhe "Partisë komuniste Marksiste Leniniste të shqiptarëve në Jugosllavi" ("PKML-SHJ") dhe prej datës 19 .02. 1982 "Lëvizja për republikën shqiptare në kuadër të Jugosllavis", dhe me datën 09 maj të vitit 1982 të ngritur në këmbë para flamurit kombëtar shqiptar kanë dhënë betimin me fjalë: "do të luftojmë psiqikisht, moralisht politikisht dhe fizikisht për republikën shqiptare në Jugosllavi dhe në fund nëqoftëse është nevoja do ta flijojmë edhe jetën", pas çkafit janë angazhuar në shpërndarjen e afisheve armiqësore ndaj vendit tonë: "komunikatës" dhe "Thirrjes" e kjo e fundit më përmbajtje: "në të cilën ftohen punëtorët, fshatarët, qytetarët, nxënësit dhe studentët, njerzë të çdo moshe që me datën 26 .06. 1982 kur fillon Kongresi i XII i LKJ të lëshojnë punën, dyqanet, fushat e arat dhe të dalin në rrugë me qëllim të brohoritjes dhe të kërkojnë të drejtat e veta për krijimin e Republikës së Kosovës në Jugosllavi", e të cilat krejtë kanë pasur përmbajtje armiqësore,

- me këtë secili veç e veç, kanë kryer veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.2. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevolucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ.

Andaj, kjo gjykatë në bazë të dispozitave të përmendura ligjore dhe me aplikimin e neneve 33., 41. të LPJ dhe të nenit 351 të LPP, i



## G J Y K O N

Të akuzuarin Regjep Mehmetin ME DENIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 8 (tëtë) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05 .08. 1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit

Të akuzuarin Shefqet Dibranin ME DENIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 5 (pesë) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05 .08. 1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit.

Të akuzuarin Qerkin Pecin ME DENIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 3 (tri) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05 .08. 1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit.

Të akuzuarin Mustafë Mulollin ME DENIM BURGIMI në kohë zgjatje prej 4 (katër) vjetësh në të cilën i llogaritet edhe koha e tij e kaluar në paraburgim prej datës 05 .08. 1982 e tutje deri në plotëfuqishmërin e aktgjykimit.

Të gjithë të akuzuarit obligohen që të paguajnë dhe ate solidarsisht në emër të shpenzimeve të procedurës penale shumë sipas fletës definitive të shpenzimeve si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili nga 800,00 din., krejtë këto brenda 15 dite nga dita e plotëfuqishmëris së aktgjykimit.

Në bazë të nenit 353. al.6. lidhur me al.1. dhe al.2. të LPP, kundër të akuzuarëve vazhdohet paraburgimi.

Në bazë të nenit 69. të LPJ shqiptohet masa e sigurimit njashtuqë mirren: makina e shkrimit e markës "Unis" TBM deluxe nr.15-5231546, makina e shkrimit e markës

"Unis" TBM deluxe nr.15-4974532, dy palë dorëza të gomës, tri cop kese të najlonit, dy llas të najlonit për pluhë artificial, si mëte me të cilat janë kryer veprat penale, 1 pushkë ushtarake "Kragujevka" të kal. 7,9 mm. nr.123980, 1 revole "Zastava" M-57" nr.I-116541 të kal.7,61 mm., 1 revole "Zbrojevka Vzor 50" nr.D-677321 të kal.7,55 mm., 1 thikë dy tëhëshe me dorzë të ilisturar me fotografit e dy artisëve, municioni: 24 fishek të pushkës të kalibrit 7,9 mm., 17 fishek të revolës të kal. 7,61 mm., 4 fishek të revolës të kalibrit 7,65 mm. 1 brush për pastrimin e gypit të revolës, 1 kuti me patenta "Meega", për shkak të sigurimit të përgjithshëm, librat dhe fletushkat: "Historija e partisë së punës së Shqipris", fletushkat "Kruja e partisë", organ i KQ të PPSH nr.2/78 dhe 11/78, librat: "vetëadministrimi Jugosllav teori dhe praktikë kapitaliste", "Demokracia proletare është demokraci e vërtetë", "Teorija dhe praktika e revolucionit", "Hrushqovi në gjunjë para Titos", "si duhet kuptuar dhe si duhet luftuar rrethimi imperialisto revizionist i vendit tonë dhe efekti i presionit të tij mbi ne", "Letër e KQ të PPSH dhe qeverisë së RPSSH drejtuar KKT PK të Kinës dhe qeverisë Kineze", "Mbi bazat e "eninizmit", "Lufta e PPSH për ndërtimin e bazës ekonomike të socializmit", një egzemplarë i statutit të "LNQK-VSH", shumë egzemplarë të marrunë të afisheve "Komunikat" dhe "Thirrje", si mëte të destinuara për kryrjen e veprave penale.

#### A r s y e t i m i

Prokurorija publike e qarkut në Mitrovicë të Titos ka ngritur aktakuzën PP-nr.84/82 të datës

02 .02. 1983 kundër: Regjep Mehmetit për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.2. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevulucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ, Shefqet Dibranit, Qerkin Pecit dhe Mustafë Mulollit, secilit veç e veç për veprën penale Bashkimi për veprimtari armiqësore nga neni 136. al.2. të LPJ lidhur me veprën penale Cenimi kontrarevulucionar i rregullimit shoqëror nga neni 114. të LPJ. Pranë kësaj aktakuze gjatë tërë shqyrtimit kryesor ka ngelur në tërësi edhe përfaqësuesi i saj, zëvendës PPQ në Mitrovicën e Titos Faruk Korenica, i cili në fjalën e vet përfundimtare i propozon gjykatës që të akuzuarit për veprat penale me të cilat akuzohen të deklarohen fajtor dhe të ndëshkohen sipas ligjës.

Avokati Mehmet Dushku nga Prishtina, mbrojtësi i të akuzuarit Regjep Mehmetit, në fjalën e vet përfundimtare deklaroi se nuk u vërtetue që i akuzuari Regjep ka qenë udhëheqës dhe organizator i grupit armiqësor të "treshit" pasi që me pamëdyshje u vërtetue se organizatori i këtij grupi ka qenë Ymer Berisha ndërsa Ky ka qenë vetëm antar i këtij grupi. Prandaj në rastë më të pavolitshëm, në veprimet e Regjepit mund të egzistojnë vetëm elementet e veprës penale nga neni 136. al.2. të LPJ. Pastaj, qëllimi i këtij grupi ka qenë vetëm që të shpërndahej materiali propagandistik, kështu që, nëse gjykata nuk akcepton tezën e parë të mbrojtjes, mund të flitet vetëm për veprën penale nga neni 133. al.1. të LPJ. Me rastin e matjes së denimit në fund e lutë gjykatën që në ënën e të akuzuarit Regjep të merrë parasysh një morri rrethanash lehtësonjëse.

Avokati Abedin Naxhiu nga Mitrovica e Titos, i caktuar sipas detyrës zyrtare për mbrojtës të të akuzuarëve Shefqet Dibrani dhe Mustafë Mulollit, në fjalën e



vet përfundimtare deklaroi: se në provat e nxjerruna nuk u vërtetua që të mbrojturit e tij kanë qenë antarë dhe pjesëmarrës të grupit armiqësor "treshit" dhe nuk kanë shpërnda material armiqësor. Prandaj, propozon gjykatës që të mbrojturit e tij të lirohen nga aktakuzat, e në rastë më të pavolitshëm, nëse gjykata gjenë se në veprimet e këtyre egzistojnë elemente inkriminuese, propozon që ndaj tyre të shqiptohet një dënim sa më adekuat.

Avokati Zaim Istrefi nga Mitrovica e Titos, mbrojtësi i të akuzuarit Qerkin Pecit, në fjalën e vet përfundimtare deklaroi: se edhe pse i mbrojturi i tij ka rënë në konfliktë me ligjin, është bërë antarë i grupit "treshit", ka dhënë betimin, ai nuk ka ditë se cilës organizatë i takon, çfarë qëllimesh ka kjo dhe kush tënjejten e ka formuar. I akuzuari Qerkin është antarsua në këtë grup duke qenë i informuar nga i akuzuari Regjep Mehmeti dhe Ymer Berisha se qëllimi i këtij grupi është vetëm shpërndarja e materialit propagandistik e për këtë, në rastin konkret mund të flitet vetëm për veprën penale propagandë armiqësore, me rastin e matjes së dëimit propozon gjykatës që të merr parasysh një morri rrethanash lehtësonjëse duke shqiptuar një dënim sa më adekuat.

I akuzuari Regjep Mehmeti, në mbrojtjen e vet, si në procedurën parapake ashtu dhe në shqyrtimin kryesor, thekson se është antarsue në grupin e ashtuqujtur "treshi" që është pjesë përbërse e organizatës: "Lëvizje për republikën shqiptare në Jugosllavi" e jo pjesë përbërse e "LNQK-VSEJ" dhe "PKML-SHJ", se bashkë me Ymer Berishën dhe të akuzuarin Qerkin Pecin e kanë dhënë betimin si antarë të këtij "treshi" se bashkë me Ymer Berishën kanë marrë material armiqësor kundër RSPJ nga Turqija, se këtë material që të tretë i kanë shpërnda, se çdo antar i këtij "treshi" ka pas për detyrë të formojë njëherit "tresha".


të rinjë, dhe se qëllimi kryesor i organizatës antarë i së cilës është, ka qenë që të formohet "Republika shqiptare në kuadër të Jugosllavis".

I akuzuari Shefqet Bibrani në mbrojtjen e vet gjatë hetuesis nuk mohon faktet se nga i akuzuari Hegjep ka marrë material propagandistik: fletushkat "Zëri i Kosovës" nr.2-3 në brendin e njerës prej tyre ishte futur afishi "thirrja" për organizimin e demonstratave e datës 26 .06. 1982, se që nga vitit 1979 ka marrë libra dhe revista me përmbajtje armiqësore dhe të botuara jashta vendit tonë nga Sabri Novosella, se ka dhënë një betim me përmbajtje armiqësore ndaj vendit tonë, por këtë betim, mbrohet ai, e paska dhënë në dyqanin e Sabri Novosellës duke qitur duert para flamurit kombëtar shqiptar dhe duke lexuar betimin qysh i ka thënë Sabriu. Ndërkaq në shqyrtimin kryesor i akuzuari Shefqet tani në tërësi i mohon edhe ato thënje të dhëna para gjyqtarit hetues, duke theksuar se aktakuza ndaj tij është tërësisht e montuar nga organet e sigurimit, se gjatë jetës së tij kur nuk është marrë me veprimtari armiqësore, nuk ka marrë prej askujt e as që ka pas në shtëpi material armiqësor, nuk dhënë kurrfarë betimi dhe nuk ka qenë e as që din për grupin armiqësor të tërë "treshit".

I akuzuari Qerkin Feci, në mbrojtjen e vet si në hetuesi ashtu dhe në shqyrtimin kryesor nuk i mohon faktet se është bërë antarë i grupit armiqësor "treshi", ka dhënë betimin e qëllimi i këtij grupi ka qenë me karakter demokratik propagandistik vetëm që të njihet statusi i "Kosovës republikë", e jo për ndonjë qëllim tjetër e për këtë ka marr vesh prej të akuzuarit Hegjep Mehmetit dhe Ymer Berishës të cilët edhe i kanë propozue që të antaresohet në këtë grup. Pastaj, nuk i mohon faktet se ai, si antar i këtij grupi ka bërë shpërndarjen

e materialit armiqësor. Mirëpo, në arsyetimin e shkakut se sepse është antarësue në këtë grup i njejtë mbrohet duke theksuar se ka qenë i demoralizuar pasi është përjashtuar nga puna, një kohë të gjatë ka ndejtë pa punë, i cili demoralizim ke ai paska kalue në revolt, e në pytjen e bërë ai përgjigjet se ka qenë i revoltuar ndaj atyre personave legjitim të cilët përfaqësojnë organet e pushtetit.

I akuzuari Mustafë Mulolli, në mbrojtjen e tij në procedurën paraprake, nuk i mohon faktet se që nga vitit 1975 ka marrë libra me përmbajtje armiqësore, se duke lexuar këto libra e duke përcjell programin e TV Tiranës është frymzuar me veprimtari armiqësore dhe është marrë me shkrimin e disa poezive që kanë karakter armiqësor ndaj vendit tonë, se në shoqëri me Naim Shalën, Enver Tupellën dhe të akuzuarin Regjep Mehmetin, ka zhvilluar bisedë rrethë formimit të një grupi për veprimtari armiqësore, se me 26 .03. 1981 ka marrë pjesë në demonstratat armiqësore në Prishtinë, se ka organizue me 31 .03. 1981 bojkotimin e mësimit të nxënëve në Universitetin e punëtorëve në Prishtinë, se në muajin mars. 1981 ka shpërndar disa parulla armiqësore, se ka pas në posedim afishin "Komunikat" por mbrohet se këtë afishe ka marrë prej Osman Facollit me qëllim shumzimi dhe shpërndarjeje, se në Prishtinë është takue me të akuzuarin Regjep dhe nga "Komunikata" bashkë kanë nxjerr afishin "thirrje" për demonstratat e 26 .06. 1982 të cilat i ka shumzue e pastaj shpërnda në Podujevë. Mirëpo, i njejtë, në mbrojtjen e vet gjatë shqyrtimit kryesor i mohon në tërësi edhe këto thënje të dhëna në hetuesi duke u mbrojtur se nuk pajtohet me thënjet nga aktakuza, se nuk është antar i kurrfarë organizate ilegale dhe nuk ka dhënë kurrfarë betimi për ndonjë organizatë armiqësore.



Pas çmuarrjes së provave të nxjerruna, Gjykata e qarkut vërtetojë gjendjen faktike vijuese:

Para demonstratave kontrarevolucionare në Kosovë të muajëve mars, prill të vitit 1981, të akuzuarit: Regjep Mehmeti, Shefqet Dibrani, Qerkin Peci dhe Mustafë Mulolli, janë marrë me aktivitete të organizuara kontrarevolucionare dhe armiqësore ndaj RSFJ. Kështu, Regjep Mehmeti, Mustafë Mulolli dhe Naim Shala, punëtorë të Fabrikës së amortizerëve në Prishtinë kanë zhvilluar biseda me përmbajtje armiqësore ndaj vendit tonë e njëherit këta kanë organizuar edhe ndërprerrjen e punës në këtë fabrikë. Me 26 .03. 1981 të akuzuarit Regjep dhe Mustafë, kanë marrë pjesë në demonstratat armiqësore në Prishtinë, për çka janë denuar me burgim nga gjyqtari për kundërvajtje e pastaj që të dytë janë përjashtuar nga marrëdhënja e punës. I akuzuari Qerkin Peci ka marrë pjesë në demonstratat kontrarevolucionare në Mitrovicën e Titos me datën 03 .04. 1981 për çka është denuar me burgim nga gjyqtari për kundërvajtje dhe in është ndërprerë marrëdhënja e punës si mësimdhënës i gjuhës dhe letërsisë shqipe e gjatë vuajtjes së këtij denimi në Burgun e Smrekovicës është njohtuar me të akuzuarin Regjep Mehmetin. I akuzuari Shefqet Dibrani qysh kah fundi i vitit 1979 është furnizuar me libra, revista dhe broshura, të gjitha të botuara në Tiranë, të cilat kanë pas karakter armiqësor ndaj RSFJ e të cilat me rastin e paraburgimit gjatë bastisjes në shtëpinë e tij janë gjetë dhe janë marrë.

Nga mesi i muajit shkurt të vitit 1982, i akuzuari Regjep Mehmeti, në Mitrovicën e Titos ka formuar grupin armiqësor të ashtuquajtur "treshi" të përbërë prej të akuzuarëve Shefqet Dibrani, Qerkin Peci dhe Mustafë Mulolli i cili grup është pjesë përbërëse e organizatave armiqësore: "Lëvizja nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve tjera të banuara me shqiptar në Jugosllavi"

("LNCK-VSHJ") dhe "Partis komuniste Marksiste Leniniste të shqiptarëve në Jugosllavi" ("PKM-LSHJ") dhe prej datës 19 .02. 1982 këto dy organizata janë shkërrirë në një të vetme të ashtuquajtur "Lëvizja për republikën shqiptare në kuadër të Jugosllavis". Deri te arritja e formimit të këtij "treshi", i ndihmuar dhe sipas udhëzimeve të ekstremit armiqësor Ymer Berishës, i akuzuari Regjep Mehmeti ka ndërmarr disa veprime paraprake. Kështu në shkurt të vitit 1982, bashkë me Ymer Berishën, ka udhëtuar në Turqi me qëllim të caktuar, që të lidhen me emigracionin ekstrem shqiptar për të marrë instruksione e udhëzime rrethë formimit të grupit në vend i cili kishte me zhvilluar aktivitetet armiqësore ndaj sistemit RSFJ. Në ad-pazar të Turqisë takohet me emigrantët ekstrem nga Kosova Sabri Maxhuni dhe Sabri N. me të cilët janë marrë vesh që në Kosovë të formojnë grupin armiqësor që do të punojë për organizatën "Lëvizja për republikën shqiptare në Jugosllavi". Me tu kthyer nga Turqija për në Jugosllavi prej këtyre emigrantëve, i akuzuari Regjep e Ymer Berisha marrin: afishin "Komunikat" në të cilën bëhet fjalë për shkërrirjen e organizatave të përmendura armiqësore në një të vetme të quajtur "Lëvizja për republikën shqiptare në Jugosllavi". Në këtë afishe njëherit bëhet fjalë për instruksionet e punës së mëtejme armiqësore. Përveqë kësaj Regjepi dhe Ymeri nga emigrantët ekstremë i kanë marrë edhe dy numra nga tre egzemplar (gjashtë copa) të fletushkës "Zëri i Kosovës" nr.1. e 2., organ i kësaj organizate ekstreme emigrante shqiptare në perëndim, që të sillin në Jugosllavi me qëllim të shpërndarjes e propagimit. I akuzuari Regjep kur kthehet nga Turqija në vend, fillon të punojë për "Lëvizjen", duke formuar "treshin" armiqësor, ashtuqë si u tha më lartë, angazhon dhe ia arrinë qëllimit që të antarsojë në këtë "tresh": bashkëfshatarin e tij të akuzuarin Shefqet Dibrain, të akuzuarin Qerkin Pecin me të cilin më parë është njohur gjatë vuajtjes së denimit të burgut në Smrekovnicë duke

bashkëpunuar me ekstremin armiqësor Ymer Berishën, dhe të akuzuarin Mustafë Mulollin, kolegun e dikurshëm të punës me të cilin qysh më parë ka pas bisedë rrethë formimit të një grupi armiqësor. I akuzuari Regjep, në shtëpinë e vet, bashkë me Ymer Berishën, me makinë të shtypit, kanë shtypur "Komunikatën" në 90 egzemplar, i kanë vu në koverta të adresuara personave të ndryshëm në territorin e KSAK duke i shpërndarë nëpër posta të ndryshme e njëherit duke lënë në vendë të ndryshme të KSAK. Një prej marrësve të kësaj "komunikate" ka qenë edhe i akuzuari Qerkin Peci, me të cilin pastaj i akuzuari Regjep bashkë me Ymerin këthehet në kontakt dhe ia arrinë qëllimit që të antarësoj në këtë "trash". Në prezencë të akuzuarit Regjep me datën 09. maj 1982, të akuzuarit Shefqet, Qerkin dhe Dibran, të ngritur në këmbë kanë dhënë betimin me fjalë: "do të luftojmë psikikisht, moralisht, politikisht dhe fizikisht për republikën shqiptare në Jugosllavi dhe në fund nëqoftëse është nevoja do ta flijojmë edhe jetën". Qëllimi i këtij grupi ka qenë tejet armiqësor dhe kontrarevucionar ndaj sistemit të RSPJ, e detyrat konkrete të antarëve të grupit kanë qenë që në ilegalitet të punojnë në shumzimin, shpërndarjen e afisheve dhe materialeve armiqësore për indrokttrinimin e numrit sa më të madh të njerëzve që të punojnë në organizatën e "lëvizjes", e njëherit secili antarë ka pas për detyrë të formojë "trash" të rinj. Ymer Berisha nga Turqija prej emigrantëve ekstremë sjell materiale të reja armiqësore duke u dhënë të akuzuarit Regjep që ato të lexohen, shumzohen dhe shpërndahen. Në mesin e këtyre materialeve ishin 6 egzemplar të fletushkës "Zëri i Kosovës" nr.3 dhe origjinali i afishës "thirrje". Teksti i afishes "thirrje" kishte këtë përmbajtje: "në të cilën ftohen, punëtorët, fshatarët, qytetarët, nxënësit dhe studentët, njerzë të çdo moshe që me datën 26 .06. 1982 kur fillon Kongresi i XII i LKJ të lëshojnë punën, dyqanet, fushat e arat dhe të dalin në rrugë me qëllim të brohoritjes dhe të kërkohen të

drejtat e veta për krijimin e republikës së Kosovës në Jugosllavi" i akuzuari Regjep pastaj kontakton me secilin të akuzuar veç e veç, dhe që të gjithë angazhohen në shumzimin dhe shpërndarjen e kësaj afisheje. Mënyra e shumzimit dhe e shpërndarjes së kësaj afishe ishte e njejtë si me ate të "komunikatës". Njëherit, të akuzuarit i kishin ndarë teritorët ku kanë vepruar në shpërndarjen e afisheve. Kështu, i akuzuari Qerkin ka shpërndarë afisheet në teritorin e Mitrovicës së Titos, i akuzuari Mustafë në teritorin e Podujevës, i akuzuari Regjep në teritorin e Vuçitërnës dhe të Përbicës, Ymer Berisha në teritorin e Prishtinës e në një rastë të akuzuarit Regjep dhe Shefqet bashkarisht kanë shpërndarë afisheet duke filluar prej fshatrave të Vuçitërnës e duke shkuar deri në Gradicë të Glogovcit. I akuzuari Regjep diku në mars të vitit 1982 pas mesnate në një shtore afër stacionit të autobusave në Velika Reka KK Vuçitërnë i ka shkruar parullat armiqësore "Kosova republikë" dhe "jashtë apo poshtë trathtarët". Ky grup ka pas për detyrë të formojë komitetin i cili do të kishte kryesin prej 9 antarëve, kryetarin, sekretarin dhe arkatarin dhe është kandashtë të punojë dhe kordinej në mënyrë ilegale dhe të formohet pas Kongresit të XII të LKJ.

Gjendjen e këtillë faktike kjo gjykatë e vërtetojë pas çmuarrjes së gjithanshme dhe të plotë të provave të nxjerruna: me ndëgjimin e dëshmitarit Gjevat Isufit, me leximin në dëshmin e dëshmitarit Fahri Vishit të dhënë në hetuesi, me vështrimin në materialin propagandistik hollësisht të theksuar në dispozitivin e aktgjykimit në pjesën ku flitet për masën e sigurimit, të cilat përputhen: gadi në tërësi në deklaratat e të akuzuarëve Regjep dhe Qerkin si në hetuesi ashtu dhe në shqyrtimin kryesor, pjesërisht në deklaratat e të akuzuarëve Shefqet e Mustafë të dhëna në hetuesi.

Nuk janë kontestuese faktet: se është formuar grupi armiqësor "treshi", se antarët e të njejtit kanë dhënë betimin para flamurit kombëtar shqiptar të cekur më lartë, se janë marrë me shpërndarjen e afisheve "komunikata" dhe "thirrja", se i kanë lexuar fletushkat "Zëri i Kosovës" se tërë materiali armiqësor si edhe orgjinalet e afisheve të përmendura i kanë marrë nga emigracioni i jashtëm në Turqi me qëllim të leximit, shumzimit dhe shpërndarjes, se ky grup ka punuar në ilegalitet, se çdo antarë i të njejtit ka pas për detyrë me punue "tresha" të rij me qëllim të masovizimit sa më të madh të ithtarëve, përkitazi me tekstin e përmbajtjes së afisheve të përmendura.

Me vështrimin në afishen "komunikat" orgjinalin e të cilit ky grup i "treshit" ka marrë nga emigracioni i jashtëm të cilin fakt e pohon edhe i akuzuari Regjep, kjo gjykatë vërtetojë faktet përkitazi me tekstin e kësaj afisheje ku bëhej fjalë për shkrirjen e dy organizatave armiqësore në një të vetme të përmendura më lartë. Prandaj me pamëdyshje konkludohet se ky grup i "treshit" së pari ka qenë pjesë përbërse e dy organizatave të para të përmendura e pastaj është bërë pjesë përbërse e organizatës së fundit të përmendur armiqësore. I akuzuari Regjep pohon se është antar i organizatës "lëvizja për republikën shqiptare në Jugosllavi" ndërsa mohon se është antar i atyre dy organizatave të para të përmendura edhe pse kjo nuk është me rëndësi, kjo gjykatë këtë mohim të të njejtit e hudhi poshtë me vështrimin në afishen e përmendur.

Prej deklaratës së Regjepit, vërtetohet se ai ka qenë pjesëmarrës i demonstratave në Prishtinë me 26 .03. 1981 për që arsye është largue nga marrëdhënja e punës, se vazhdon të mirret me veprimtari armiqësore duke kontaktuar me Ymer Berishën, pastaj me emigrantët Sabri Maxhunin dhe Sabri N. prej të cilëve ka marrë udhëzime për veprimtari armiqësore e qëllimi kryesor ka qenë




formimi i grupit "treshit" ashtuqë pastaj secili antarë i "treshit" të formojë grupin e vet, se prej Turqisë është furnizuar me material armiqësor. Mirëpo ky pasiqë privohet nga lirija, me qëllim të shmangjes goftë edhe të pjesërishme të përgjegjesisë penale sepse është i vetëdijshëm se si organizator dhe udhëheqës i grupit mbanë peshën më të madhe të përgjegjesisë se sa si antarë para organeve të ndjekjes, pa bazë përpigjet të justifikohet duke theksuar përpos atyre që u thanë më lartë, se ai kinse paska qenë vetëm antar ndërsa si organizator i këtij grupi paska qenë Imer Berisha e në këtë grup e pranon vetëm antarësin e të akuzuarit Qerkin kurse të akuzuarit Shefqet e Mustafë i eliminon. Në këtë drejtim nëse analizohet hollësisht deklarata e tij e dhënë në hetuesi dhe në shqyrtimin kryesor në të cilën shihet se ai ka qenë në kontakt me secilin të akuzuar dhe me lidhjen e pjesërishme të deklarave të të akuzuarit tjerë, do të shihet qartazi se kjo mbrojtje e Regjepit është e pa bazë. Kështu, duke u nisur nga faktet jo kontestuese se ky "tresh" ka punuar në ilegalitet, se shumzimi dhe shpërndarja e afisheve të përmendura kanë qenë të njohura vetëm antarëve të "treshit", pastaj duke u nisur nga deklarata e Qerkinit në të cilën ai pranon se është antar i grupit, nga deklaratat e të akuzuarëve Regjep dhe Mustafë të dhëna në hetuesi në të cilat këta deklarojnë se në Prishtinë kanë pas takime se Mustafa është njohur me afishet e përmendura e pastaj ka shumzue dhe shpërnda afishin "thirrje" në Fodujevë, nga deklaratat e Regjepit dhe Shefqetit të dhëna në hetuesi në të cilat pranojnë se i kanë shpërnda afishet "thirrjet" prej fshatrave të Vuçitërnës e deri në Gradicë të Gllgovcit, vetëvetiu rrjedhë konkludimi i kësaj gjykate se organizator dhe udhëheqës i këtij grupi ka qenë i akuzuari Regjep ndërsa antarët kanë qenë të akuzuarit tjerë. Me këtë drejtim çdo verzion tjetër që rrjedhë nga mbrojtja e të akuzuarëve është i gabuar, sepse këta në verzionet e tyre



shihet interesi i të njejtëve për shmangjen e tërsishme apo qoftë edhe të pjesërishtme të përgjegjësive penale. Kështu si u tha më lartë, i akuzuari Regjep përpiqet që të japi verzionin se ai kinse paska qenë antarë ndërsa Ymeri organizator i këtij grupi e për me u kompletue edhe një antarë ai tregon vetëm të akuzuarin Qerkin. I akuzuari Shefqet në hetuesi deklaroi se ka dhënë betimin si antar i grupit por pa bazë përpiqet të justifikohet se këtë e ka dhënë para Sabri Novosellës e gjatë betimit i ka përsërit fjalët e Sabriut, se kinse nuk ka ditë se cilës organizatë i takon ky grup, se pranon faktin që me Regjepin kanë shpërndarë afishen "thirrje" por mbrohet se ai këtë vetëm e ka shoqëruar, se prej Regjepit ka marrë "Zërin e Kosovës" nr.1. e 2., se më parë prej Sabriut qysh prej vitit 1979 është furnizuar me libra, fletushka armiqësore, kështuqë sipas konkludimit të gjykatës, i akuzuari Shefqet në hetuesi përpiqet edhe pjesërisht të shmangjet përgjegjësive penale duke hudhë fajin në Sabri Novosellën për të cilin fare mirë din se ai gjindet në emigracion në Turqi duke u përpjekur me e mësuhë faktin se është antarsue në "trash" se betimin e ka dhënë edhe i akuzuari Regjep. Mirëpo, Shefqeti, edhe këto thënje pjesërisht pohuese por të cilat pak a shumë kanë lidhë mëri me provat materiale dhe deklarimet e të akuzuarit Regjep në shqyrtimin kryesor të njejtat në tërësi i demanton duke shkuar aqë saqë tani deklaroi se kur nuk është marrë me veprimtari armiqësore, nuk është furnizuar dhe nuk ka pas në shtëpi asnjë libër, fletushkë apo broshurë armiqësore e haron faktin se me rastin e bastisjes në shtëpinë e tij janë gjetë materialet armiqësore të cilat janë cekë në dispozitivin e aktgjyqimit e të cilat janë marrë me vërtetim.

Verizionin e të akuzuarit Mustafë Mulollit, në të cilën ai vehten nuk e futë në grupin e "trashit"



kjo gjykatë e hudhë poshtë si të pa bazë sepse duke u nisur nga deklarata e të njejtit në hetuesi në të cilën thot se ka pas në posedim afishen "komunikat" se prej të njejtës bashkë me Regjepin i kanë nxjerrë afishen "thirrje" të cilën pastaj e ka shumzue dhe shpërnda në Podujevë, vetëvetiu tregon lidhmërin e këtij me Regjepin përkitazi me veprimtarin e tyre armiqësore që rrjedhë nga aktiviteti i këtij grupi edhe pse nuk mund të pranohen të thënat e këtij se prej "komunikatës" bashkë e kanë nxjerr "thirrjen", sepse me pamëdyshje vërtetojnë se origjinalet e këtyre afisheve janë sjellë nga emigracioni i jashtëm e nuk kanë pas këta çka të nxjerrin prej njerës për të përpilue afishen tjetër, por këta i kanë pas detyrat e veta konkrete të cilat rrjedhin nga veprimtaria e grupit e të cilat kanë qenë shumzimi dhe shpërndarja e afisheve, si edhe kanë bërë.

Kjo gjykatë refuzojë të dhënat e të akuzuarëve Shefqet dhe Mustafë në shqyrtimin kryesor, në të cilat këta pa bazë e me qëllim të shmangjes së përgjegjesisë penale theksojnë se deklaratat që i kanë dhënë në hetuesi janë të montuara dhe të dhëna nën presionin e organeve të sigurimit sepse këta në këtë drejtim nuk ofrojnë asgjë bindëse e aqë më tepër kur dihet që këta deklaratat i kanë dhënë para gjyqtarit hetues ku nuk ka pas pjestarë të sigurimit dhe ndonjë presion çfardo lloji, a për ndryshe edhe sikur të ishte ashtu qysh këta theksojnë, në deklaratat e tyre këta kishin me pranue në tërësi e jo pjesësisht si kanë veprue egzistimin e veprave penale në drejtim të së cilave u zbatue hetuesija ndaj tyre.

Nga gjendja faktike më lartë e vërtetuar, gjykata e çarkut gjenë se në veprimet e të akuzuarëve egzistojnë elementet qenjësore të veprave penale hollësisht të përshkruara në dispozitivin e aktgjykimit, për të cilat këta deklarohen fajtor dhe penalisht përgjeggjës.

Nga arsyet më lartë të cekura, u refuzuan si të pa baza, tezat e mbrojtjes së mbrojtësve dhe të vet të akuzuarëve.

Në kuptim të nenit 41. të LPJ, kjo gjykatë muarr parasysht të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e matjes së denimit. Kështu, si rrethana lehtësonjëse të të gjithë të akuzuarit gjeti se këta janë persona relativisht të rinjë, se, përpos të akuzuarit Shefqet, të tjerët janë të martuar, kanë fëmij, më parë nuk kanë qenë të denuar. Ndërsa si rrethana rëndojëse muarr: të të gjithë të akuzuarit faktin se këta një kohë të gjatë janë marrë me aktivitete armiqësore të cilat i kanë shprehë edhe me pjesëmarrjen e tyre në demonstratat kontrarevucionare në Kosovë, vendosshmërin e tyre të shkallës së lartë që të jenë sa ma aktiv në kryrjen e veprimeve armiqësore që shihet në shumzimin dhe shpërndarjen e numrit të madh të afisheve dhe në dhënjen e betimit në tekstin verbal të të cilat qartaz shihet se këta kanë qenë shumë të eksponuar armiqësisht ndaj RSFJ, te i akuzuari Regjep: përpjekja e tij permanente dhe e vendosur në formimin e "treshit" duke i bindë dhe maksimalisht angazhue antarët e grupit në shumzimin dhe shpërndarjen e afishefe, angazhimin e tij që sa më shumë material armiqësor të merr nga emigracioni i jashtëm dhe pastaj të njejtat ti shpërndaj. Prandaj, duke marrë parasysht këto rrethana dhe me aplikimin e dispozitave ndëshkuese nga neni 136. al.1. lidhur me nenin 114. të LPJ për të akuzuarin Regjep dhe nga neni 136. al.2. lidhur me nenin 114. të LPJ për të akuzuarit tjerë, gjykata të akuzuarit i gjykoje me denime burgimi të cekura në dispozitivin e aktgjykimit, duke qenë plotësisht e bindur se më këto denime me pamëdyshje do të arrihet qëllimi i denimeve nga neni 33. të LPJ.

Kjo gjykatë vendosi që ndaj të akuzuarëve të vazhdohet paraburgimi në bazë të nenit 353. al.6.

./...

lidhur me al.1. dhe al.2. të LPP.

Vendimin mbi shqiptimin e masës së sigurimit,  
kjo gjykatë muarr me aplikimin e nenit 69. al.1. dhe al.2.  
të LPJ.


Nga sa u tha më lartë, u vendos si në di-  
spozitivin e aktgjykimit.

GJYKATA E QARKUT MITROVICË E TITOS  
F-nr.9/83, - më 27 .05. 1983.

PROÇESMBAJTËSJA,  
Mevlyde Hamza, d.v.

KRYETARI I TRUPIT-GJYQTARI,  
Jusuf Mejzini, d.v.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar  
ankesa brenda 15 dite nga dita e marrjes,  
përmes të kësaj gjykate, Gjykatës  
supreme të Kosovës në Prishtinë.



SAKTESIN E KOPIJES E VERTETON  
DREJTORI I SHKRIMTORES SE GJYKATES  
ЗА ТАЧНОСТ ОТПРАВКА  
УПРАВИТЕЛ СУДСКЕ ПИСАРНИЦЕ

*[Handwritten signature]*